Durrës më, 07.05.2024

# Akt Themelimi

**I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

“AooS 2”

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe kodin civil ne fuqi te Republiken e Shqiperise ne ligjin nr 9901 te dates 14.04.2008 per tregetaret dhe shoqerite tregetare, dhe dispozitat e tjera te legjislacionit Shqiptar ne fuqi qe rregullojne maredhenjet e Shoqerive Tregetare.

Ortaku themelues:

**Vjosa Kalemi I paisur me nr ID** I56102035H_krijone Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar “AooS 2” sh.p.k me akt themelimi si vijon :

## Formulim

**Neni 1**

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur “AooS 2” sh.p.k . Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

## Selia e Shoqerise

**Neni 2**

Selia e shoqerise tregtare private “AooS 2” sh.p.k do te kete seline kryesore **Durres, Lagjja Nr.3, Rruga Egnatia, Zona Kadastrale 8514, Pallati XHEMF, Kati 1.** Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijoje filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem .

## Objektivi I Veprimtarise

**Neni 3**

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise do te jete:

1. **Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat :** Zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit te sherbimeve, kerkimeve,konsulences, projekteve, manaxhimit dhe studimeve te te githa llojeve. Sherbimi ne posten elektronike dhe ne internet dhe sherbim telefonik nepermjet internetit. Kryerja e investimeve ne te githa fushat dhe kryesisht per ndertime civile, industriale, turistike, buqesore ne infrastrukture etj. Investimi i kapitalit dhe i mjeteve te tjera financiare, per blerje te pasurive te luajtshme dhe te paluatshme dhe ne vazhdim te aktivitetit te saj, shitja e tyre, per te arritur qellimet e shoqerise. Realizimi i kontratave, marreveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo i formave te tjera te lejuara nga legislacioni shqiptar, me persona fizike dhe juridike, shiptare ose te huaj, per te realizuar operacione industriale,

Vjosa Kalemi

Digitally signed by Vjosa Kalemi
Date: 2024.05.07 14:48:22 +02'00'

tregtare dhe veprimtari te ndryshme qe jane te nevojshme dhe me interes per shoqerine si dhe cdo lloj aktiviteti qe do t'i sherbeje realizimit te objektit te shoqerise.

2. Sidoqofte, asgje nuk do te interpretohet ketu si kufizim i mundesise se shoqerise per te hyre ne tregje apo aktivitete dhe operacione te tjera tregtare pavaresisht se keto aktivitete te mundshme nuk jane permendur ketu shprehimisht.

## Kohezgjatja e Shoqerise

**Neni 4**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per nje periudhe 5(pese vjet) e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar,data 07.05.2024 deri 06.05.2029
Afati i permendur ne piken 1 te ketij neni mund zgjatet me vendim te Ortakut te vetem, ne perputhje me rregullat e percaktuara nga ky Statut me perfundimin e periudhes se percaktuar me siper.

## Kapitali I Shoqerise

**Neni 5**

Kapitali fillestar I shoqerise private “AooS 2” s h.p.k do te jete 100.000(njeqind mije leke).
Kapitali i perket aksionerit te vetem te shoqerise, **Vjosa Kalemi**
Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet ( por jo nen vleren nominale te kapitalit themeltar fillestar ).

## Drejtimi I Shoqerise

**Neni 6**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj **Vjosa Kalemi,**ortaku i Shoqerise dhe perfaqesuesi ligjor i saj . Ai eshte perfaqesuesi I Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .
Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues I pajisur me prokure te posacme .

**Neni 7**

Kapitali i perket aksionerit te shoqerise, **Vjosa Kalemi**
**Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakut te vetem , e ndare ne 1 kuot** .
Kuotat e Kapitalit Themeltar mund t’u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, pasi te jete marre miratimi i ortakeve te tjere te shoqerise, duke respektuar te drejten e parablerjes, kur transferimi behet me ane te shitjes

**Neni 8**

Ortaket kane te drejte te emeroje nje administrator, financiere, likujdator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake

a. Ortaku i vetem Z. Vjosa Kalemi
b. Administratori Z. Vjosa Kalemi

Vjosa Kalemi

Digitally signed by Vjosa Kalemi
Date: 2024.05.07 14:48:22 +02'00'

**Neni 9**

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar ne Gjykaten e Rethit Gjyqesor Durres.

**Neni 10**

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

**Neni 11**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Krijimin e Shoqerive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

**Neni 12**

Akti I themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise “AooS 2” sh.p.k

Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku I vetem .

ORTAKU I VETEM THEMELUES

“AooS 2”

**Vjosa Kalemi**



Vjosa Kalemi

Digitally signed by Vjosa Kalemi
Date: 2024.05.07 14:48:22 +02'00'